



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura VIII  
Sesioni vjeshtor

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 9  
Prishtinë, më 8.10.2021, në orën 13:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haki Abazi, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Dimal Basha, Ariana Musliu-Shoshi, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

**Munguan:** Branislav Nikoliq, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi dhe Kujtim Shala.

**Në këtë takim ishte i ftuar:** z. Tomáš Szunyog, udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Blerta Bejtullahu dhe Samir Karahoda, EUSR; Marigonë Arifi, KDI; Gresa Bytyqi, MPJD; Arbenita Mjekiqi, KK; Jon Krasniqi, PIPS; Arbresha Asllani, AAK; Ermira Gashi, Kuvend; Shumbin Halabaku, KP-VV; Arbër Fetahu, GLPS; Arton Musliu, GP-PDK dhe Elena Elshani, Kuvend.

**Nga Zyra e komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Takimin e kryesoi:** Haki Abazi, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

Takim me z. Tomáš Szunyog, udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë, lidhur me agjendën dhe marrëdhëniet e Kosovës me BE-në.

**Haki Abazi**, bëri të ditur se qëllimi i këtij takimi është që komisioni ta ketë mundësinë e bashkëbisedimit me përfaqësuesin e BE-së në temat, të cilat i preokupojnë të dy palët, në mënyrë të veçantë, disa nga aspektet kryesore të angazhimit të BE-së në Kosovë, dhe në anën tjetër, obligimet dhe përgjegjësitë e legjislativit kundrejt agjendës së integritit evropian. Ai falënderoi përfaqësuesin e BE-së për kontributin që BE-ja ia ka dhënë Kosovës gjatë menaxhimit të pandemisë, me përkrahjen e të cilëve Kosova ka arritur në mënyrë të shpejtë vaksinimin, por edhe posedimin e barnave për përballimin e pandemisë. Kërkoj nga ambasadori që ta informojë komisionin, lidhur me pikëpamjet e tij sa i përket proceseve të brendshme dhe obligimeve që i ka Kosova, të asaj se çfarë është parë në Bërdo, për çështjen e liberalizimit të vizave, si dhe çështje të tjera. Shprehu mendimin se çështja e krizës së energjisë në BE, është çështje delikate dhe në

këto situata është e rëndësishme që të qartësohet se a është me të vërtetë krizë apo është një paraprirje e një spekulimi për mundësinë e shkurtimeve të furnizimit me energji në BE, rrjedhimisht industria bën ngritjen e çmimeve si formë të përgjigjes. Lidhur me këtë, kërkoi të dëgjojë nga ambasadori sesi mund të menaxhohet kjo çështje, në mënyrë që qytetarët të kenë sa më pak pasoja në kuptimin e shtrenjtimit të energjisë elektrike. Më tej, shtoi se zbatimi i Planit kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, është çështje e cila mund të diskutohet, edhe pse ky komision nuk është drejtpërdrejt, në përgjegjësi, si dhe kërkoi nga ambasadori të reflektojë se çfarë pritet të përfshihet në Raportin e Progresit, që pritet të vijë së shpejti për Kosovën.

**Tomáš Szunyog**, tha se është i vetëdijshëm se komisionet parlamentare dhe Kuvendi janë elementi kryesor në ligj-bërjen, dhe në këtë kontekst, elementi kryesor për progres në tërë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së. Samiti për Ballkanin Perëndimor, i mbajtur në Bërdo dhe vizita e Presidentes së Komisionit Evropian në Ballkan, tha se e ka konfirmuar që Ballkani Perëndimor mbetet prioritet për BE-në dhe deklarata e miratuar nga liderët ka demonstruar se perspektiva evropiane për Ballkanin Perëndimor është e interesit të përbashkët strategjik. Në Bërdo, tha se janë ri-konfirmuar përkushtimet në procesin e zgjerimit dhe vendimet janë marrë duke u bazuar në reformat kredibile të partnerëve. Bëri të ditur se BE-ja, përmes planit për investime ekonomike, është duke mobilizuar rreth 30 miliardë euro për rajonin, përmes të cilit planifikon të përshpejtojë rimëkëmbjen ekonomike, të lehtësojë tranzicionin e gjelbër dhe të mbështesë bashkëpunimin me BE-në. Ai njoftoi se Komisioni Evropian është duke përgatitur një plan të investimeve në vlerë prej 600 milion euro për IPA 2020-2021, për zbatimin e planit të investimeve ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe janë deklaruar edhe rreth 500 milionë euro investime për këtë vit. Më tej, theksoi se BE-ja, së bashku me vendet anëtare, ka mbështetur Ballkanin Perëndimor gjatë gjithë kohës së pandemisë dhe ka ofruar mbështetje socio-ekonomike me rreth 3.3 miliardë euro deri më tani. Sa i përket Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, tha se ai do të publikohet në mes të këtij muaji dhe është i gatshëm që të gjeturat e tij t'i diskutojë me këtë komision, me Komisionin për Integritet Evropian ose me cilindo komision të Kuvendit, i cili është i interesuar për këtë dokument. Bëri të ditur se Kuvendi e ka miratuar Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe planin e veprimit për agjendën evropiane dhe për miratimin e tij ka pranuar mbështetjen e të gjitha partive politike në Kuvend. Lidhur me çështjen e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, tha se kjo është shkaktuar nga mungesa e furnizimit, e cila është shkaktuar me rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike, pas krizës së Covid-19. Po ashtu, tha se Kosova është duke regjistruar një rritje ekonomike me rreth 8% GDP dhe kjo është një situatë e ngjashme në të gjitha vendet në rajon dhe në tërë Evropën. Pritjet e BE-së për Kosovën janë që Qeveria, së bashku me mbështetjen e Kuvendit, të fokusohen në miratimin e një strategjie të re kombëtare të energjisë. Më tej, shtoi se kjo strategji duhet të jetë në pajtueshmëri me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe me Marrëveshjen e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila është miratuar në samitin e Ballkanit Perëndimor së Sofje. Kosova duhet ta ketë një përkushtim të qartë për tranzicionin e energjisë në pajtueshmëri me Marrëveshjen e Gjelbër, por edhe në pajtueshmëri me obligimet që dalin nga traktatet e Parisit dhe nga takimi që do të mbahet në Glasgou. BE-ja, tha është e gatshme që ta mbështesë Kosovën, në këtë drejtim, si në aspektin teknik me ekspertiza ashtu edhe në aspektin financiar, por kërkon që të finalizohet sa më parë strategjia për energji.

**Haki Abazi**, tha se ekziston një përzierje e emocioneve rreth takimit në Bërdo, i cili na kthen një kujtim të përkushtimit nga Selaniku, ku nuk është pranuar afati kohor për vitin 2030 dhe blloku i integritetit nuk u pranua. Ai shtoi se është e drejtë të thuhet se meritat vlerësohen, në rast se nuk

përsëritet rasti i Maqedonisë së Veriut dhe i Bullgarisë në pakon e radhës të zgjerimit, ku jo vetëm është vonuar rasti i Maqedonisë së Veriut dhe i Shqipërisë, por kushedi se çfarë do të kishte bërë Serbia nëse do të kishte hyrë në BE.

**Tomáš Szunyog**, lidhur me samitin në Bërdo, tha se ka pasur ndoshta më shumë pritshmëri të ngritura në sferën publike dhe media sesa që është diskutuar në realitet nga ata që ishin duke i përfaqësuar vendet e tyre. Deklarata e dalë nga ky samit, tha se është një dokument i mirë, në të cilën shihet se çfarë është diskutuar dhe se në të ka tema të caktuara, për të cilat BE-ja është e përkushtuar që të punojë bashkë me Ballkanin Perëndimor. Pritshmëria e tij, lidhur me samitin e dytë që do të mbahet në vitin 2022, nën kryesimin e Republikës Çeke, tha se është që ky samit të mbahet në baza të rregullta me vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili krijon mundësi të mirë për të përgatitur një agjendë që mund të caktojë procedura, grupe punuese dhe mund të çojë deri te rezultatet e prekshme për gjithë popullatën e rajonit, por edhe për BE-në.

**Ariana Musliu-Shoshi**, tha se e vlerëson prezantimin e z. Szunyog dhe gjithë mbështetjen që Kosova e ka marrë nga vendet anëtare të BE-së. Ajo pyeti ambasadorin: Cila është pengesa kryesore sa i përket Kuvendit dhe Qeverisë drejt rrugës së BE-së dhe se çfarë mund të bëjë Kuvendi që ta lehtësojë rrugën drejt BE-së? Cili është problemi kryesor, me të cilin është duke u përballur Kosova, sa i përket liberalizimit të vizave? Po ashtu kërkoi nga ambasadori, nëse ai mund t'i tregojë tri çështje që Kuvendi mund t'i bëjë, në mënyrë që ta lehtësojë procesin e liberalizimit të vizave.

**Tomáš Szunyog**, lidhur me anëtarësimin e Kosovës në BE, shprehu mendimin se sfida kryesore është se Kosova, edhe pse ka miratuar një numër të dokumenteve të rëndësishme, mungon zbatimin i mirë i këtyre dokumenteve. Më tej, theksoi se MSA-ja është një dokument bazik në mes të BE-së dhe Kosovës dhe vitin e kaluar është shënuar pesë vjetori i nënshkrimit të saj, por brenda këtyre pesë viteve, Kosova nuk i ka zbatuar as 50% të obligimeve që i ka marrë. ERA 1 dhe ERA 2 janë dokumente të cilat janë të miratuara nga Kuvendi dhe Qeveria, këto tha se nuk janë duke u zbatuar. Sa i përket liberalizimit të vizave, tha se ekziston një keqkuptim në atë se çfarë do të thotë liberalizimi i vizave. Ajo çfarë ne jemi duke biseduar është liberalizimi i vizave turistike për 60 ditë, kurrë nuk ka qenë fjala për studentë ose për viza pune. Në nivelin e institucioneve të BE-së, njoftoi se Presidentja e Komisionit Evropian e ka konfirmuar se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe se liberalizimi i vizave duhet t'i jepet Kosovës. Kjo është cekur disa herë që nga viti 2018 dhe do të ceket prapë në raportin, të cilin do ta publikojë Komisioni Evropian për Kosovën. Ai shtoi se vendimi për këtë çështje nuk merret nga KE-ja, por nga Këshilli i Ministrave dhe varet nga shteti, i cili e ka kryesimin dhe nga situata në Këshill, nëse dhe kur do të merret një vendim për ta kaluar këtë çështje. Lidhur me këtë çështje, sugjeroi se Kosova duhet të diskutojë me institucionet e BE-së, me Këshillin e Evropës, por po ashtu edhe me vendet anëtare, sepse i duhet mbështetja e 27 vendeve anëtare. Ai, po ashtu, shtoi se misionet diplomatike që i ka Kosova në vendet e BE-së duhet të shfrytëzohen siç duhet dhe çështjen e liberalizimit të vizave duhet ta kenë me prioritet.

**Ariana Musliu-Shoshi**, tha se sa i përket zbatimin të MSA-së, ERA 1 dhe 2, e kupton problematiken. Pyeti: A do ta kishte ndihmuar në këtë proces, nëse Kosova do ta kishte një Ministri për Integrim Evropian. Bëri të ditur se për t'u pajisur me vizë, një qytetar i Kosovës duhet të presë

me radhë për disa orë dhe duhet të presë disa muaj për të caktuar një termin dhe kjo nuk është një gjë e mirë për vendin dhe rininë e Kosovës.

**Time Kadrijaj**, njoftoi në cilësi të anëtares së Komisionit për integritet evropian, se në mënyrë unanime është votuar agjenda për reformën evropiane, e cila së shpejti edhe në Kuvend të marrë përkrahjen nga pozita e opozita. Në vijim, theksoi se është ftuar zëvendëskryeministri, z. Bislimi, për të raportuar për zbatimin e MSA-së dhe zbatimin në dikastere veç e veç, në mënyrë që aty ku ka ngecje në zbatim, të ftohen ministrinë për raportim, për shkaqet e ngecjeve. Sa i përket samitit të fundit, tha se i vjen mirë që BE e ka në agjendë integritimin e Ballkanit Perëndimor, ngase rruga e vetme e Kosovës, është drejt BE-së. Kosova është e përkushtuar në përmbushjen e kriterëve për liberalizim të vizave dhe të procesit të integritimit të saj. Më tej, shtoi se si Kosovë kërkojmë nga vendet e BE-së, që me rastin e integritimit të Ballkanit Perëndimor, integritimi të ndodhë për të gjitha vendet, ngase është padrejtësi që dikush të marrë statusin e vendit kandidat e dikush jo. Ajo falënderoi BE-në, për përkrahjen që i është dhënë Kosovës gjatë pandemisë, si dhe për investimet e shumta në Kosovë, meqë Kosova ka nevojë për përkrahje të miqve të saj.

**Tomáš Szunyog**, falënderoi për mbështetjen për IPA 2020 dhe theksoi se tani janë në fazën e përgatitjes së IPA 2021, e më pas, është faza IPA 3 dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë për çështjet e përmendura. Sa i përket vizave, tha se janë duke biseduar për liberalizimit të vizave turistike, ndërsa sa i përket integritimeve evropiane, nuk kanë ndonjë rregull sesi të organizohet brenda vendeve që janë duke u përpjekur të bëhen anëtare të BE-së. Gjashtë vendet e rajonit, kanë modele të ndryshme të procesit të integritimeve që janë duke i ndjekur, mënyra e organizimit të procesit të integritimeve nuk është e rëndësishme, por e rëndësishme është që një vend të ketë lidhshmëri politik mbi agjendën evropiane, si dhe kapacitete të mjaftueshme administrative. Statusi i vendit kandidatit është një synim i mirë, por duhet të ketë punë të zellshme për ta arritur këtë, e po ashtu është shumë e rëndësishme që Kosova të aplikojë dhe të pranohet ky aplikim, e jo të ndodhë e kundërta, tha ai.

**Haki Abazi**, lidhur me dialogun Kosovë-Serbi dhe zbatimin të masës së reciprocitetit për targat, ajo që kemi parë, tha se është brengosëse, por njëkohësisht edhe inkurajuese ishte përgjigjja e shpejtë e BE-së dhe NATO-s, që siguria e Kosovës dhe siguria në rajon të mos cenohet nga asnjë veprim që mund të tërheqë kapacitetet ushtarake, të cilat i pamë që presidenti i Serbisë i vuri në veprim, në rastin e targave. Pyeti ambasadorin Tomáš Szunyog, se në çfarë momenti e konsideron ai që dialogu nuk është veç një justifikim i prolongimit të mospërmbushjes së procesit të normalizimit të marrëdhënieve, që si duket është në favor të Serbisë, e cila megjithatë vazhdon me hapjen e kapitujve. Një prej përkushtimeve të Bërdos, është vazhdimi i hapjes së kapitujve përderisa në rastin e Kosovës, përkundër mirëkuptimit, kushtimisht për kriteret teknike dhe korrupsionit që përsëritet nga disa prej anëtarëve të shteteve anëtare, ende qëndron në nivelin e parë të lëvizjes së lirë. Për qytetarin e Kosovës, procesi evropian është edhe e drejta për lëvizje të lirë, e mos të flasim për moszbatimin e instrumentit për zgjerim e mospërfshirjes së Kosovës në strategjinë e zgjerimit, më herët, shtoi ai. Po ashtu, tha se prolongimi me vite e dekada i proceseve ka ndikuar në ikjen e trurit e që është brengosëse, si për institucionet publike, ashtu edhe për ato private.

**Tomáš Szunyog**, theksoi se nuk dëshiron të hyjë në çështjet të cilat janë kompetencë e z. Lajçak. Z. Lajçak është mandatar nga 27 vendet anëtare dhe mandati i tij është që të lehtësojë

marrëveshjen, e cila do të jetë gjithëpërfshirëse dhe obligative në aspektin ligjor. Emërimi i z. Lajçak, ai e ka ndryshuar metodologjinë e fundit të dialogut nga marrëveshjet e ndara, individuale në një gjithëpërfshirëse, për të cilën metodologji është pajtuar me qeverinë e mëparshme të Kosovës dhe me Vuçiqin. Me ardhjen e qeverisë së re, tha se kemi pasur angazhime të reja dhe qeveria e re ka dashur t'i rishikojë të gjitha marrëveshjet paraprake, gjë që ka kërkuar kohë dhe janë mbajtur disa takime. Më tutje, tha se BE-ja është një lehtësues që mund të lehtësojë vetëm atë, për të cilën dakordohen të dyja palët. Temat, të cilat janë diskutuar më së shumti, ishin shumë të rëndësishme, ajo e personave të zhdukur dhe ka pasur progres në këtë drejtim, që do të thotë se mund të kemi edhe më shumë progres. Edhe EULEX-i është mjaft i rëndësishëm në këtë çështje, duke qenë prezent në terren në varrezat masive. Eskalimi i situatës, lidhur me targat e regjistrimit, ka qenë një krizë deri në një nivel, por besoj se kjo mund të shndërrohet në një mundësi për kuptim më të mirë, mbi të cilin ne duhet të diskutojmë me dialog.

**Dimal Basha**, falënderoi z. Tomáš Szunyog, për pjesëmarrjen në këtë takim, njëkohësisht edhe vendet e BE-së për përkrahjen që i dhanë vendit tonë, sidomos gjatë kohës së pandemisë. Z. Basha theksoi se jemi me fat që jemi evropianë dhe dëshirojmë të jemi pjesë e Evropës, por kemi shumë vështirësi që të udhëtojmë. Theksoi se është punë shumë e vështirë për z. Tomáš Szunyog, të qëndrojnë para nesh, ashtu siç ndihet edhe vet z. Basha, kur qëndron përpara njerëzve, për shkak se janë ata të cilët e marrin mandatin nga njerëzit dhe i përfaqësojmë ata. Liberalizimi i vizave kërkon shumë çështje teknike, por rinia jonë nuk i kupton politikat e BE-së. Ata e shohin BE-në si një tërësi, si një organ, dhe është shumë e rëndësishme t'i ndajmë vlerat e përbashkëta të BE-së. Të rinjtë tanë thonë se BE nuk na duan ne. BE e ka krijuar një vakum brenda Evropës dhe është shumë shqetësuese sesi ajo është duke integruar njerëz brenda vendeve të tyre, siç janë refugjatët të cilëve u ofron të gjitha kushtet për jetë normale. Kosovarët këtë nuk e kërkojnë, tha z. Basha. Ne dëshirojmë të udhëtojmë dhe të rinjtë tanë të vizitojnë universitetet, ngase dëshirojnë të bëhen pjesë e tyre. Sa i përket negociatave, keni thënë se eskalimi ka qenë një krizë, por si përfaqësues i BE-së duhet thënë se ne nuk e kemi eskaluar situatën, por vetëm kemi kërkuar reciprocitet.

**Tomáš Szunyog**, sa i përket liberalizimit të vizave, tha se për këtë mesazh është duke raportuar çdo 6 muaj në vendet e BE-së dhe gjithnjë e shton një paragraf për liberalizimin e vizave e po ashtu theksoi se mosvendosja për vizat është duke e dobësuar BE-në. Sa i përket tabelave të veturave, tha se është çështje e z. Lajçak dhe janë të kënaqur që tani ekziston një marrëveshje e përkohshme dhe shpresojmë që brenda muajve, dyja palët mund të gjejnë një zgjidhje të përbashkët, e cila do të zgjidhë këtë çështje për një periudhë më të gjatë kohore dhe do të lehtësojë lëvizjen e lirshme të njerëzve në vend.

**Haki Abazi**, tha se paragrafi nga viti 2011, që është zgjatur për 5 vite, pas një periudhe kaq të gjatë, çdonjëri ka të drejtë të bëjë pyetje, nëse po i bën të gjitha këto kompromise dhe në fund rezultati është që Serbia vazhdon të diskriminojë, ndërsa në anën tjetër nuk shihet asnjë progres, sigurisht që vjen një moment, i cili i detyron institucionet për të thënë që vullneti ynë i mirë politik, kompromiset e bëra nuk kanë rezultuar në reflektim. Në anën tjetër, tha se është moment i ri, pavarësisht se mund të duket që nuk është respektuar, në fakt është respektuar një javë pas kalimit të marrëveshjes dhe Kosova duhet të kërkojë pozicionin e vet të barabartë. Z. Abazi, po ashtu ceku se katër S, që shkruhen në tabelat e Serbisë, janë logoja me të cilat janë bërë të gjitha krimet në Ballkan, gjatë viteve të 90-ta dhe ky nivel i ofendimit dhe përkujtimit të krimit për një vend aspirant në BE, nuk do të duhej të kishte vend. Pajtohem, tha z. Abazi, se fatmirësisht kemi një marrëveshje

të përkohshme për gjashtë muaj, e që do të duhej së paku tabelat e ardhshme të reflektojnë vlerat evropiane të të dyja vendeve edhe Kosovës, edhe Serbisë.

**Time Kadrijaj**, kërkoi që Kosova të trajtohet e barabartë në BE, njëjtë si Kosova, si Serbia dhe të shkohet në përfundim të dialogut, sepse stërzgjatja e dialogut, Kosovës i ka humbur kohë e energji, në vend se të koncentrohet në zhvillim ekonomik, shëndetësi e arsim. Kosova është shtet i pavarur e i njohur nga rreth 120 shtete, të cilin realitet duhet ta pranojë edhe Serbia. Më tej, tha se procesi i dialogut duhet të përfundojë me njohje reciproke në kufijtë aktualë. Kërkoi nga z. Tomáš Szunyog, që shqetësimet lidhur me dialogun dhe liberalizimin e vizave t'i përcjellë në të gjitha instancat, ku ai raporton, dhe kjo padrejtësi ndaj qytetarëve të Kosovës, të hiqet, që edhe ne të lëvizim lirshëm, si gjithë vendet e Ballkanit.

**Tomáš Szunyog**, theksoi se sa i përket dialogut Serbia dhe Kosova janë trajtuar të barabarta. Dialogu është mënyra e pashmangshme, i cili ia hap dyert Kosovës drejt anëtarësimit në BE dhe mënyrë e vetme e cila duhet të shfrytëzohet për të mirën e saj dhe të rajonit.

**Haki Abazi**, falënderoi Tomáš Szunyog, për këtë takim të sinqertë, duke ritheksuar nevojën për realizimin e detyrimeve tona që i kemi nënshkruar për proceset reformuese ERA 2 dhe të gjitha obligimet tjera që i kemi si shtet. Në vazhdim, tha se Evropa, BE, procesi i integritit, gjithashtu janë platformë unifikuese ndërmjet gjithë spektrit politik, por edhe rëndësia e veçantë e kontributit të shoqërisë civile, për të cilën BE ka dhënë dhe vazhdon të jetë një prej kontribuuesve kryesor. Shoqëria civile, sigurisht se do të ketë nevojë edhe në të ardhmen të jetë e përforcuar me kapacitete, për ta ndihmuar këtë proces. Këtë bashkëbisedim, tha se do ta vazhdojmë tutje dhe së shpejti me publikimin e Raportit të Progresit, do të marrim përkushtime të reja për punë të mëtutjeshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

---

Haki Abazi